



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA PROKURORI I SAVETIT - DREJTAJ TUDAC Sekretariat i Shtetit të Komisioneve të Komisioneve Sekretari i Komisioneve të Ligjeve Drejtive Të Dritës ARKIVA - ARHIVA	
05 -03- 2013	
Nr./Br. 290, 2013	
PRISHTINË - PRIŠTINA	

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIK OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/TUŽILAÇKI SAVET KOSOVA/KOSOVOPROSECUTORIAL COUNCIL

Duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1.26 dhe 1.27, të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e dyzët e një të mbajtur me date 04 mars 2013, Këshilli Prokurorial i Kosovës miraton këtë:

RREGULLORE NR 01/2013

PËR
FUNKSIONIMIN DHE VEPRIMTARINË E KËSHILLIT PROKURORIAL
TË KOSOVËS

KAPITULLI I
Neni 1
Qëllimi dhe Fushëveprimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës, funksionimi dhe veprimtaria e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe komisioneve të Këshillit.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim.

- Ligj - Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Rregullore - Rregullore mbi funksionimin dhe veprimtarine e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe komisioneve të Këshillit;
- Kryetar - Kryetar i Këshillit;
- Nën-Kryetar - Nën-Kryetar i Këshillit;
- Anëtar - Anëtar i Këshillit;

- Sekretariat - Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
- KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Komision - Komisionet e Përherershme dhe të përkoheshme të themeluara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe
- Njësiti - Njësiti për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorive dhe Prokurorëve.

Neni 3
Logoja dhe vula e Këshillit

1. Këshilli ka vulën e vet zyrtare.
2. Vula përmban këto të dhëna:
 - a) në rrethin e parë të jashtëm shkruhet "Republika e Kosovë",
 - b) në rrathët e tjerë shkruhet "Këshilli Prokurorial i Kosovës",
 - c) selia e tij - Prishtinë
 - d) Në qendër të vulës vendoset stema e Republikës së Kosovës.
3. Forma dhe përbajtja e vulës së Këshillit do të jetë në përputhje me Ligjin për Vulat e Institucioneve të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI II
FUNKSIONIMI
Neni 4
Kryetari i Këshillit

1. Kryetari udhëheq me takimet e Këshillit dhe është përgjegjes për zbatimin e drejtë të dispozitave dhe procedurave të përcaktuara me Ligj, me këtë Rregullore dhe akte tjera nënligjore.
2. Kryetari bashkëpunon dhe përfaqëson Këshillin para organeve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare.
3. Bashkëpunon me individë apo organizata përgjegjëse për monitorimin e pavarur të sistemit prokurorial.
4. Kryetari mbikqyrë punën e Komisioneve të KPK-së.
5. Kryetari i Këshillit ka edhe këto përgjegjësi.
 - a) Thërrret takimet e Këshillit dhe kryeson me to.
 - b) Propozon rendin e ditës së takimeve të Këshillit.
 - c) Nënshkruan vendimet dhe dokumentet në emër të KPK-së.

- c) Udhëzon sekretariatin në kryerjen e veprimeve përgaditore lidhur me takimet e Këshillit.
- d) Mbikëqyrë, organizon dhe kordinon punën e Këshillit, në përputhje me Ligjin dhe dispozitat në fuqi.
- dh) Mbikëqyr punën administrative dhe finianciare të Sekretariatit.
- e) Kujdeset për bashkëpunimin e Këshillit me media dhe publikun.
- ë) Paraqet kërkesa për sigurimin e mjeteve dhe nënshkruan propozimin e buxhetit të nevojshëm për punën e Këshillit pas aprovimit nga ana e këshillit, dhe pas konsultimit me Kryeprokurorin e Shtetit dhe me Kryeprokuroret e prokurorive.
- f) Kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me Ligj dhe Rregullore.
- g) Delegon autorizime të anëtarët e Këshillit;

Neni 5 Nën Kryetari i Këshillit

1. Këshilli zgjedh Nën-Kryetarin e Këshillit nga radha e anëtarëve - prokuror për një mandat tre (3) vjeçar. I zgjedhuri në këtë pozitë nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Këshillit.
2. Secili anëtarë i Këshillit mund të propozoj një anëtar të KPK-së për nën-kryetar. Nën-kryetari zgjidhet me shumicë të thjeshtë të votave, përmes votimit të fshehtë.
3. Nën-Kryetari në rastë mungese apo pengese të Kryetarit të KPK që ushtroj përgjegjësit e tij, udhëheq takimet e KPK-së dhe kryen punë nga fushëveprimi dhe autorizimet e tij.
4. Sipas nevojës Nën-Kryetari ndihmon Kryetarin në përbushjen e detyrave të tij.
5. Nën-Kryetari mund të shkarkohet para skadimit të mandatit sipas propozimit të Kryetarit apo se paku tre anëtarve të Këshillit, për shkak të përformancës se dobët apo shkaqeve të parapara në nenin 11 të Ligjit.
6. Vendimin për shkarkimin e Nën-Kryetarit merret me shumicen e thjesht të votave, përmes votimit të fshehtë.

Neni 6 Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e KPK-së janë të obliguar:
 - a) Të marrin pjesë dhe të kontribojnë në punën e KPK-së;
 - b) Të marrin pjesë dhe të kontribojnë në punën e komisioneve dhe grupeve punuese të themeluara nga KPK.

- c) Të kryejnë punë tjera të caktuara nga KPK në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të KPK-së.
 - ç) Zbatojnë dispozitat e Ligjit, Rregullave dhe të akteve tjera të brendshme të Këshillit.
 - d) Anëtarët e Këshillit janë të detyruar t'i përbahen Kodit të Etikës për anëtarët e Këshillit.
 - dh) Nëse është e mundshme, anëtarët paraprakisht informon Kryetarin apo sekretariatin në qoftë se nuk mund të merr pjesë në takim të Këshillit.
 - e) Ti sigurojnë Sekretariatit informacionet e nevojshme lidhur me llogaritjen e kompensimeve të parapara në këtë Rregullore, dhe
 - ë) Nuk zbulojnë informacione që kanë të bëjnë me procesin e marrjes së vendimeve të Këshillit;
2. Gjatë vendimmarrjes në çështjet që vendoset në Këshill, anëtarët janë të obliguar që të veprojnë në atë mënyrë që të evitohet anshmëria, konflikti i interesit apo diskriminimi mbi çfarëdo baze.
 3. Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre dhe shpenzime të tjera në Këshill në pajtim me shumën monetare të përcaktuar me këtë rregullore.
 4. Anëtarët e Këshillit në përputhje me nenin 6.5 të Ligjit deklarojnë me shkrim mos përputhshmërinë mbi antarësinë në KPK.

Neni 7 Regjistri i anëtarëve të Këshillit

1. Sekretariati e mban regjistrin e anëtarëve të Këshillit dhe mandatet e tyre.
2. Regjistri duhet të mbaj të dhëna mbi datën e emërimit dhe datën e skadimit të mandatit, përfshirë edhe të dhëna tjera personale dhe profesionale.
3. Sekretariati do të informoj Këshillin së paku 90 ditë para skadimit të mandatit të një anëtarë të Këshillit.

Neni 8 Betimi

Pas emërimit secili anëtar i Këshillit duhet të betohet solemnisht. Teksti i betimit është si në vijim:

"Solemnisht deklaroj dhe premtoj se do t'i kryejë funksionet në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale me qëllim të përmbrushjes së obligimit Kushtetutës dhe Ligjor".

Neni 9
Dorëheqja e anëtarëve të Këshillit

1. Anëtari i Këshillit është i obliguar që së paku tridhjetë (30) ditë përpara t'ia paraqes dorëheqjen e tij Kryetarit dhe Këshillit.
2. Me dështimin e vazhdueshëm për të marr pjesë në veprimtarit e Këshillit për më shumë tre (3) muaj

Neni 10
Vendet e lira në Këshill

1. Nëse një vend në Këshilli lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati. Anëtari, përveç Kryeprokurorit të Shtetit apo Ministrit të Drejtësisë, i cili zgjidhet të plotësojë një vend të lirë në Këshill emërohet apo zgjidhet me një mandat të plotë pesë (5) vjeçar.
2. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit nga radhët e prokurorëve do të rregullohet me akt të brendshëm të veçantë.

Neni 11
Përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Këshillit dhe njoftimi i Këshillit

1. Në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Këshillin Prokurorial Nr. L/03-224, dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli, anëtarët e Këshillit do të janë subjekti i masave disiplinore në rastet kur:
 - a) Veprimet e tyre kanë dëmtuar autoritetin e Këshillit dhe sistemit prokurorial.
 - b) Nuk kanë deklaruar konfliktin e interesit në Këshill, dhe
 - c) Shkelin rregullat e Kodit të Etikës për anëtarët e Këshillit Prokurorial.
2. Procedura disiplinore ndaj një anëtari të Këshillit mund të filloj pas një hetimi të zhvilluar sipas nenit 11 të Ligjit për Këshillin Prokurorial Nr. L/03-224, dhe ne bazë të rregullores së KPK-së mbi proceduren disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit.

Neni 12
Mbështetja administrative për Këshillin

1. Mbështetja administrative për Këshillin sigurohet në përputhje me nenin 14 të Ligjit për për Këshillin Prokurorial Nr. L/03-224, dhe Rregulloren për Strukturen Organizative dhe Funksionin Mbështetës Administrativ të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

KAPITULLI III

TAKIMET E KËSHILLIT
Neni 13
Orari i takimit dhe njoftimi

1. Këshilli parimisht mban takime një herë në muaj. Përjashtmisht Këshilli mund të mbaj takime kur do që e konsideron të nevojshme. Kryetari mund të përcaktojë orarin e takimeve në përputhje me kërkesat e punës në Këshill, me kusht që për këtë t'i njoftoj me kohë anëtarët e Këshillit.
2. Njoftimi për takimet e Këshillit publikohet në ueb faqen zyrtare të Këshillit.
3. Në parim, takimet e Këshillit janë të hapura për publikun.
4. Këshilli në rastet e parashikuara me ligj me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm mund të vendos të mbajë një takim të mbyllur për publikun.
5. Kryetari kërkon largimin e publikut dhe personave të tjerë prezenca e te cilëve nuk është e nevojshme.
6. Shënimet e takimit të mbyllur do të përgatiten ashtu siç parashihet me ligj dhe me këtë rregullore.

Neni 14
Gjuhët

Takimet dhe dokumentet përgatiten dhe mbahen në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin.

Neni 15
Takimet e jashtëzakonshme

1. Me kërkesë të Kryetarit apo të së paku tre (3) anëtareve mund të thirret një takim i jashtëzakonshëm i Këshillit për të shqyrtaur çështjet urgjente. Anëtarët duhet të njoftojn për këtë takim dhe për pikat e rendit të ditës të paktën njëzet e katër (24) orë para takimit të tillë.
2. Një takim i jashtëzakonshëm i Këshillit mund të thirret me kërkesë me shkrim të dorëzuar tek Kryetari nga jo më pak se tre (3) anëtarë. Anëtarët duhet të lajmërohen për këtë takim dhe për pikat e rendit të ditës të paktën njëzet e katër (24) orë para takimit të tillë.

Neni 16
Konflikti i Interesit dhe Përjashtimi

1. Anëtari i Këshillit mbanë përgjegjësin për të shmangur konfliktin e interesave në bazë të mardhenjeve familjare dhe shoqërore në pajtim me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interest.
2. Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit meson për ndonjë konflikt interes apo përfundo rrethana tjera që mund të ngren dyshime në lidhje me pa anësin e tij/saj, ai/ajo do i ndërpret të gjitha veprimtarit mbi rastin dhe menjëherë të njofton Kryetarin e Këshillit me shkrim në lidhje me atë situate.
3. Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit e fsheh, respektivisht nuk e raporton ndonjë rrethan të konfliktit të interest apo çfardo rrethane tjetër që mund të ngrisë dyshime në lidhje me panësin e tij/saj, por ndonjeri nga anëtarët e Këshillit ka njohuri për këtë rrethanë, do të ishte e detyrueshme për këtë anëtar që këtë rrethan tja raportoj Kryetarit të Këshillit.

Neni 17 Kuorumi dhe Vendimet e Këshillit

1. Kurumi për takimet e KPK-së është me 6 anëtar dhe vendimet e KPK-së mirren me shumicën e thjesht të votave nga anëtarët e pranishëm, përveqëse nëse Ligji e përcakton ndryshe.
2. Në rast të votave të barabarta edhe për here të dytë, konsiderohet se propozimi nuk kalon.
3. Vendimet e Këshillit janë publike, përpos rasteve të parapara me Ligj.

Neni 18 Rendi i Ditës

1. Anëtarët e Këshillit duhet të dorëzojnë propozimet e tyre Kryetarit për pikat e rendit të ditës së paku (7) ditë para takimit.
2. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari. Rendi i ditës iu dergohet anëtarëve të Këshillit jo me pak se tri (3) ditë pune para takimit.
3. Rendi i ditës do ta publikohet në ueb faqen zyrtare të Këshillit.
4. Pikat e rendit të ditës renditen sipas rëndësisë së tyre.
5. Çështjet e rëndësisë së veçantë mund të hyjnë si pika të rendit të ditës vetëm nëse paraprakisht miratohen nga anëtarët e Këshillit, dhe nëse e njëjta pike votohet nga anëtarët e Këshillit në fillim të takimit të Këshillit.

Neni 19
Rrjedha e takimit

1. Para hapjes së takimit Kryetari konstaton numrin e anëtarëve të pranishëm të Këshillit dhe sigurohet se ka kuorum për mbajtjen e takimit. Kryetari konstaton ne procesverbal nëse ndonjë anëtar i Këshillit largohet gjatë takimit të Këshillit dhe konstaton nëse ka apo jo kourum për vazhdimin e takimit.
2. Nëse kryetari konstaton se nuk ka kuorum takimi nuk mbahet ose ndërpritet.
3. Pas hapjes së takimit Kryetari propozon rendin e ditës. Këshilli vendos për miratimin e rendit të ditës të propozuar përmes votimit.
4. Pas miratimit të rendit të ditës, Këshilli miraton procesverbalin nga takimi paraprak.
5. Kryetari hap shqyrtimin për çdo pike të rendit të ditës veç e veç. Radhitja e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës mund të ndryshohet me miratimin e anëtarëve të Këshillit.
6. Pika e rendit të ditës që nuk merr shumicën e thjeshtë të votave do të konsiderohet e hequr.
7. Anëtarët e Këshillit gjatë diskutimeve do të jenë sa më konciz dhe të qartë. Kryetari kujdeset për menaxhimin e kohës së diskutimeve dhe mund të vendos kufizime të arsyeshme kohore mbi diskutimet gjatë mbledhjes.
8. Të drejtë diskutimi në takimet e Këshillit kanë vetëm anëtarët e Këshillit. Përjashtimisht, me leje të kryetarit të Këshillit edhe persona të thirrur nga Këshilli mund të jenë pjesë e diskutimit.
9. Pas përfundimit të shqyrtimit Kryetari propozon marrjen e vendimit dhe e hedh në votim çdo pike të rendit të ditës veç e veç.
10. Në rast të një takimi të jashtëzakonshëm, do të zbatohen rregullat e parapara në nenin 13 të kësaj Rregullore.

Neni 20
Procesverbali i seances

1. Për çdo takim të Këshillit mbahet procesverbal.. Prosesverbali përbën; vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së takimit; numrin e anëtarëve prezent, emrat e tyre si dhe emrat dhe funksionet e personave tjerë present; konstatimin pë kuorum, mbajtjen ose shtyrjen e takimit, rendi i ditës së takimit; përbajtjen e shkurtë të shqyrtimit për çdo pike të rendit të ditës; rezultatin e votimit; mendimet e ndara të anëtarëve lidhur me vendimet;

arsyet për ndërprerjen dhe shtyrjen e takimit; përfundimin e takimit dhe të dhënrat tjera nga takimi

2. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe procesmbajtësi.
3. Me vendim të Këshillit i lejohet qasja në procesverbal një personi i cili provon se ka një interes të veçantë në procesverbal.
4. Në qoftë se krijohen kushtet, takimet e Këshillit incizohen. Audio incizimet e takimeve të Këshillit janë konfidenciale.
5. Me urdhërin e Kryetarit, transkriptet e shkruara nga audio incizimet mund të bëhen publike nëse kjo gjë i shërben interesave të administrimit të drejtësisë, ose nxit transparencën në administrimin e drejtësisë, dhe vetëm nëse:
 - a) nuk komprometon integritetin e procesit të vendimmarrjes së Këshillit;
 - b) nuk shkelë interesat personale të anëtarëve të Këshillit;
 - c) nuk shkelë interesat e personave të cilët janë subjekt i shqyrtimit;
 - d) nuk shkelë dispozitat e tjera të zbatueshme të ligjit në lidhje me konfidentialitetin e diskutimeve të Këshillit.

Neni 21
Zbatimi i vendimeve të Këshillit

Vendimet e Këshillit do te zbatohen mbrenda afatit te caktuar. Në rast të problemeve, ose në prani të fakteve të reja që mund të pengojnë zbatimin e vendimeve, Drejtori duhet të informojë menjëherë Kryetarin.

KAPITULLI IV
KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE ÇASJA NË AKTET E KËSHILLIT
Neni 22
Kontaktet me publikun apo media

Komunikimi i përgjithshëm me publikun apo mjetet e informimit bëhet ne pajtim me rregullat e nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Neni 23
Faqja Zyrtare e Këshillit

1. Këshilli do te themeloj ueb faqen e tij zyrtare cila do të përditësohet me informata relevante, në pajtim me ligjin dhe rregulloret e Këshillit.
2. Web faqja e Keshillit do të shërbej si portal gjithëpërfshirës edhe për ueb faqen e Prokurorit të Shtetit ku do të postohen informata mbi punën dhe veprimtarinë e tyre.

Neni 24

Çasje në informatat e Këshillit dhe Mbrojtja e të dhënave personale

1. Me qëllim që të jet sa ma transparente puna e Këshillit, Këshilli do t'i sigurojë çasje publikut në informatat që posedon Këshilli në përputhje me ligjet në fuqi për çasje në dokumente publike njëkohësisht do të bëhet sigurimi i mbrojtjes së të dhënave të përpunuara nga Këshilli dhe Sekretariati, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Këshilli do të caktoje një person kontaktues mbi çasjen në dokumentet zyrtare dhe një person për mbrojtjen e të dhënave personale që mbahen brenda në Këshill.
3. Informatat mbi personin kontaktues do të publikohen në web faqe.

KAPITULLI V

KOMISIONET E KËSHILLIT

Neni 25

Komisionet dhe grupet punuese

1. Në pajtim me nenin 4 të Ligjit, Këshilli mund të themelojë komisione të përhershme të cilat Këshilli i vlerëson si të nevojshme për funksionimin efikas dhe ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe legjislacionin e aplikueshëm për KPK.
2. Komisionet e përhershme themelohen për të mbështetur Këshillin në ushtrimin e funksioneve të tij.
3. Komisioni i përhershëm ka më së paku tre anëtarë, të cilët Këshilli i zgjedh me mandate në kohëzgjatje sa zgjat mandati i tyre në Këshill. Anëtarët e komisioneve mund të janë edhe Prokuror.
4. Komisioni udhëhiqet nga kryetari i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit.
5. Komisionet e përhershme i përcaktojnë detyrat sipas prioritetit dhe udhëzimeve nga KPK dhe rregulloret respective të miratuara në Këshill. Komisionet vendosin me shumicë të thjesht të votave të anëtarëve të Komisionit.
6. Në raste të caktuara Këshilli mund të themelojë komisione Ad-hoc, grupe punuese të përkohshme dhe grupe të ekspertëve për çështje të caktuara. Me vendim mbi themelim përcaktohet përbërja, mandati, detyrat, mbështetja administrative teknike dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me punën e komisionit dhe grupit punues apo grupit të ekspertëve.

7. Këshilli sipas propozimit të Kryetarit mund të bëjë zëvendësimin e përkohshëm të anëtarit të komisionit apo grüpuit punues kur ai anëtar është i penguar të kryej detyrat e veta.

Neni 26
Komisionet e përhershme të Këshillit

1. Këshilli ka këto komisione të përhershme:

- a) Komisioni Disiplinor;
- b) Komisioni për Akte Normative;
- c) Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
- d) Komisioni për vlerësimin e Përformancës së Prokurorive.

Neni 27
Komisioni Disiplinor

Funksionimi dhe mandati i Komisionit Disiplinor si dhe procedura para Komisionit përcaktohet me ligj dhe me Rregulloren për punën e Komisionit Disiplinor të miratuar nga Këshilli.

Neni 28
Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorive

Funksionimi dhe mandati i Komisionit dhe procedura e Vleresimit të Performances së Prokurorive përcaktohet me Rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.

Neni 29
Komisioni për Akte normative

1. Komisioni për Akte normative është kompetent dhe përgjegjës që:

- a) Të sigurojë që rregulloret dhe dokumentet e miratuara në Këshill janë në harmoni dhe pajtushmeri me Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe rregulloret ekzistuese të Këshillit.
- b) Rishikojë rregulloret dhe aktet nënligjore për funksionimin e Këshillit dhe prokurorive.

- c) Shqyrtojë dhe pregetitë rekomandime për plotësimin apo ndryshimin e rregulloreve, udhëzimeve administrative apo dokumenteve tjera para se të dërgohen në Këshill për miratim.
- d) Sipas kërkesës së Këshillit do të shqyrtojë dhe rekomandoj për plotësim ndryshim të rregulloreve apo dokumenteve të miratuara në Këshill.
- e) Sipas nevojës përmes Këshillit tek Qeveria e Kosovës të propozoj plotësim ndryshimet e ligjeve për sistemin prokurorial të Kosovës.
- f) Të monitoroj zbatimin e Rregulloreve dhe dokumenteve të miratuara në Këshill, dhe të përgaditë raport për Këshillin dhe
- g) Me kërkesë të Këshillit, të adresojë çështje tjera të lidhura me rregullat e brendshme apo çështjet legjislative.

Neni 30
Komisioni për Buxhet dhe Financa

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa është kompetent dhe përgjegjës të:
 - a) Përgatisë dhe rekomandojë politikat për zhvillim, rishikim dhe menaxhim të buxhetit të Këshillit.
 - b) Rishikojë buxhetin e propozuar, kërkesat për buxhet dhe të jep rekomandimet para Këshillit lidhur me kërkesat për buxhet.
 - c) Përgatisë dhe rekomandojë politikat tek Këshilli lidhur me menaxhimin e buxhetit dhe financave.
 - d) Me kërkesë të Këshillit, të adresojë çështjet tjera lidhur me buxhetin dhe financat dhe
 - e) Komisioni do të raportojë së paku tre (3), here në vit para Këshillit lidhur me menaxhimin e buxhetit vjetor të Këshillit.

Neni 31
Takimet e Komisioneve

1. Komisioni vendos me shumic të votave të anëtarve.
2. Komisionet miratojnë kalendarin e takimeve me propozim të kryetarit të Komisionit. Kryetari i Komisionit mund të bëjë thirrje për takime të jashtëzakonshme.

3. Secili anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë në një Komision tek i cili ai/ajo nuk është anëtar, por pa të drejtë vote.
4. Kryetari i Komisionit mund të ftojë ekspert të jashtëm për të mbështetur punën e Komisionit. Kompensimi për ekspertët e angazhuar në Komisione do të përcaktohet me Vendim të Këshillit.
5. Rregullat e takimeve të Këshillit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Komisioneve dhe ekspertëve të jashtëm aplikohen përshtatshmërisht dhe do të zbatohen edhe për takimet e Komisionit përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe në këtë rregullore.
6. Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit do ti ofrojë mbeshtetje administrative Komisionit për ushtrimin e funksioneve te tij.
7. Sekretariati do të ruaj të gjitha procesverbalet, propozimet, rekomandimet dhe raportet e Komisioneve.
8. Sipas kësaj rregullore komisionet mund të miratojnë rregulla të brendshme për punën e tyre nëse është e nevojshme.

Neni 32
Kompenzimi për anëtaret e Këshillit, Komisioneve dhe Grupeve Punuese

1. Këshilli do të marr Vendim për caktimin e lartësise së kompenzimit të Kryetarit dhe anetareve të Këshillit për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të tyre të përcaktuara me ligj dhe me këtë rregullore.
2. Këshilli do të marr Vendim për caktimin e lartësise së kompenzimit të Kryetarit dhe anëtareve të komisioneve dhe grupeve punuese të themeluara nga Këshilli apo të grupeve punuese të themeluara nga institucionet tjera por që përfaqësojnë Këshillin për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të tyre të përcaktuara me ligj, këtë rregullore, rregulloret e tjera të miratuara nga Këshilli apo legjislacionin e aplikueshëm.

Neni 33
Shpallja e konkurseve dhe emërimi i Prokurorëve

1. Këshilli merr vendim për shpalljen e konkursit.
2. Kushtet dhe Kriteret per procedurën e emërit të prokurorëve përcaktohen në pajtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial, Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe rregullat e Këshillit.
3. Këshilli miraton formularin për aplikim për pozita të lira për prokurorë.

4. Këshilli rezervon të drejtën e emërimit të numrit më të madh apo më të vogël nga pozitat e shpallura me konkurs.

Neni 34
Komisioni për vlerësimin e kandidatëve

1. Njëkohësisht me vendosjen për shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të lira për prokurorë, Këshilli cakton edhe anëtarët për vlerësimin e kandidatëve.
2. Për zgjedhja, mandati i anëtarëve të Komisionit për Vlerësim, si dhe metoda dhe procedura e vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni përcaktohet me Rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.
3. Rekomandimi i Komisionit për emërimin e kandidatëve për prokuror nuk është obligativ për Këshillin, i cili ruan të drejtën e refuzimit të propozimit për emërimin e ndonjërit nga kandidatët në listën e propozuar.

KAPITULLI VI
AKTET E KËSHILLIT
Neni 35
Rregulloret dhe Aktet nënligjore të brendshme të Këshillit

Këshilli miraton rregullore dhe akte tjera nënligjore në përputhje me Ligjin për Këshillin Prokurorial, Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe ligjet e tjera në fuqi.

Neni 36
Publikimi i Rregulloreve

1. Këshilli do të mbajë një regjistër për çdo rregullore dhe për ndryshimet e tyre, i cili do të përfshijë:
 - a) Datën e miratimit të rregullores origjinale dhe hyrjen e saj në fuqi dhe
 - b) Datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve te rregullores.
2. Rregulloret dhe ndryshimet e aprovuara nga Këshilli do të publikohen në ueb faqen e Këshillit.

3. Rregulloret si dhe ndryshimet e aprovuara nga ana e Këshillit do të shpërndahen nga ana e Sekretariatit nëpër të gjitha zyrat, njësitë e pavarura brenda Këshillit dhe tek të gjitha departamentet dhe njësitë tjera të Sekretariatit, tek Prokuroritë si dhe tek të tjerët ashtu siç kërkonhet nga Kryetari.
4. Nga personat e tjerë mund të kërkonhet që të paguajnë një tarifë për një kopje.

Neni 37
Aktet e tjera të Këshillit

1. Këshilli vendos mbi të gjitha çështjet e parapara me Kushtetutë, ligj dhe me rregulloret e Këshillit. Këshilli miraton vendime, rezoluta, propozime, opinione apo mirënjojje si dhe akte të tjera në përputhje me ligjet në fuqi dhe me rregullore të miratuara në Këshill.
2. Vendimet dhe të gjitha aktet tjera të Këshillit do të përbajnë përshkrimin e bazës ligjore, dispozitivin dhe arsyetimin.

Neni 38
Deklaratë për mbrojtjen e pavarësisë dhe autoritetit të Prokuroreve dhe sistemit prokurorial

1. Këshilli do të reagojë publikisht, me anë të një deklaratë, kundër çdo sjellje të jashtme që mund ta rrezikojë si në vijim:
 - a) Pavarësinë dhe autoritetin e prokurorëve dhe të sistemit prokurorial në tërësi dhe
 - b) Ushtrimin e rregullt të funksionit të prokurorit.
2. Kryeprokuroret, ZevendesKryeprokurori, prokuroret, dhe çdo anëtar i Këshillit mund të kërkoj ndërhyrjen e Këshillit duke paraqitur një kërkesë të arsyetur me shkrim tek Kryetari. Nese Kryetari e vlereson se kërkesa është e arsyeshme, informon anëtarët e Këshillit.
3. Në rast se kërkesa është urgjente, Kryetari ia paraqet drejtpërdrejtë Këshillit një propozim për Rezolutë.
4. Në rast se kërkesa nuk është urgjente, Kryetari mund të caktojë një anëtar për të vlerësuar kërkesën dhe të propozojë procedimin e duhur në Këshill. Anëtari reportues hapë një dosje dhe përgatitë rastin për prezantim para Këshillit. Anëtari do të ndihmohet nga Komisioni për Legislacion. Anëtari reportues mund të kërkojë informacione dhe dokumente shtesë nga cilado zyrë përkatëse e administratës publike. Pjesë të provave (siç janë gazetat, video-kasetat, dokumentet) mund të mblidhen. Anëtari reportues i drejtohet Këshillit mbi rezultatin e hetimit brenda dy (2) javësh nga

data e caktimit. Ajo/ai mund të paraqesë një rekomandim me shkrim për të mbledhur prova shtesë për të hedhur poshtë lëndën; apo për ta aprovuar rezolutën.

5. Këshilli do të votojë për deklaratën. Në raste urgjente, anëtarët e Këshillit mund ta miratojnë përbajtjen deklaratës përmes mjeteve elektronike të komunikimit. Pas aprovimit rezoluta duhet të publikohet menjëherë në ueb faqen zyrtare të Këshillit dhe/ose nëpërmjet një konference për shtyp.

Neni 39
Plani strategjik i Këshillit

1. Këshilli do të miratojë planin zhvillimor strategjik i cili do të përfshij prioritetet strategjike që mbulon një periudhë tre vjeçare.
2. Këshilli do të vlerësoj zbatimin e planit strategjik çdo gjashtë (6) muaj.

Neni 40
Raporti vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit dhe Prokurorive

1. Këshilli jo më vonë se me 15 shkurt të çdo viti kalendarik do ta përcaktojë përbajtjen e raportit vjetor për punën e tij, punën e prokurorive dhe të prokurorëve.
2. Përbajtja e raportit duhet të përfshijë të paktën:
 - a) Veprimtarinë e Komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
 - b) Veprimtarinë e Këshillit;
 - c) Veprimtarinë e grupeve punuese të caktuara nga Këshilli;
 - d) Veprimtarinë e Prokurorive;
 - e) Veprimtarinë e Prokurorëve;
 - f) Vlerësimin e çështjeve të jashtëzakonshme në lidhje me punën e Këshillit dhe prokurorive, duke përfshirë zbatimin e planeve të miratuara në vitin paraprak;
 - g) Raportimin mbi buxhetin dhe burimet njerëzore dhe
 - h) Planifikimin e aktiviteteve të Këshillit për atë vit dhe identifikimin e prioriteteve.
3. Këshilli do t'i udhëzojë Komisionet, grupet punuese dhe prokuroritë që të dorëzojnë raportet e tyre.
4. Sekretariati do të sigurojë që projekt-raporti i Këshillit të jetë përgatitur me kohë të paktën deri në fund të muajit shkurt. Projekt-raporti i dërgohet anëtarëve të Këshillit shtatë (7) ditë para takimit të këshillit, ndërsa amendamentet e propozuara me shkrim tri (3) ditë para takimit të planifikuar për miratimin e raportit.

5. Raporti do të publikohet deri në fund të marsit dhe i njëjtë do të i dërgohet Kuvendit të Kosovës dhe Presidentit.

Neni 41
Propozimi i buxhetit vjetor

1. Këshilli do ta udhëzojë Drejtorin që të përgatisë një projekt-propozim për Këshillin dhe Prokurorite në pajtim me afatin kohor të vendosur nga Ministria e Financave. Projekt-propozimi do të përfshijë propozimet e Prokurorive dhe komentet nga zyra për buxhet dhe financa e Sekretariatit dhe Komisioni për Buxhet, dhe Financa i Këshillit. Propozimi i buxhetit do të përfshijë edhe buxhetet për njësinë për shqyrtimin e performansës se Prokurorive.
2. Pas miratimit nga Këshilli, Kryetari dorëzon propozim buxhetin në Ministrinë e Financave. Në rast se buxheti i propozuar nga Ministri i Financave në Kuvend dallon nga ai i propozuar nga Këshilli, Kryetari menjëherë i informon anëtarët e Këshillit dhe do të përgatisë komentet për ti dërguar në Kuvend.
3. Kryetari do të informojë anëtarët e Këshillit për aprovimin e buxhetit nga Kuvendi.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT
Neni 42
Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores

1. Ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen në mënyrën dhe proceduren e njëjtë si në rastin e nxjerrjes së saj.
2. Propozimi me shkrim për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje mund ta paraqesin secili nga anëtarët e Këshillit. Propozimi i paraqitet Kryetarit të Këshillit së paku 15 ditë para mbajtjes së takimit.

Neni 43
Shfuqizimi i Rregullorës së Punës së Këshillit

Me këtë rregullore shfuqizohet Rregullorja e Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës e dates 4 mars 2011.

Neni 44
Rregullat e Procedurës

Këshilli do nxjerr rregullore të veçantë për procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit Prokurorial në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Këshillin Prokurorial Nr. L/03-224; Kodin e Etikës dhe sjelljes profesionale për Prokurorë, anëtarë të Këshillit, dhe stafin mbështetës,

Rregulloren për punën e Komisionit Disiplinor, Rregulloren per caktimin e kritereve dhe procedurave te vlerësimit te performances se Prokuroreve, rregullore për procesin dhe procedurat e emërimit të prokuroreve; rregulloren per komunikim me media dhe publikun, rregullore per qasje ne dokumentet publike, rregullore per mbrojtjen e te dhënavë personale.

**Neni 45
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe nënshkrimit nga Kryetari.

Miratuar më datën 04 mars 2013

